

Lista e Institucioneve publike, pjesë e sektorit Publik

Tiranë, më 08 Shtator 2017:

INSTAT, ofron për herë të parë për përdoruesin listën e institucioneve publike që janë pjesë e sektorit të Qeverisë së Përgjithshme si dhe ndërmarrjet Financiare dhe jo-Financiare që janë në pronësi të entiteteve publike.

[Lista e institucioneve publike, pjesë e sektorit publik](#)

Për hartimin e kësaj liste, INSTAT ka bashkëpunuar ngushtë me Ministrinë e Financave dhe Bankën e Shqipërisë dhe është mbështetur në udhëzimet e manualeve statistikore si: Sistemi Evropian i Llogarive (ESA 2010); Manuali i Statistikave Financiare të Qeverisë (GFSM 2014) të prodhuara nga Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe Manuali shoqëruar mbi Deficitin e Qeverisë dhe Borxhit (MGDD);

Sektori i Qeverisë së Përgjithshme përbëhet nga disa nën-sektorë: Qeveria Qëndrore, Qeveria Federale*, Qeveria Lokale, Fondet e Sigurimeve. Sektori i Qeverisë qendrore është i përbërë nga Njësitë Buxhetore dhe Njësitë Ekstra-buxhetore. Bashkimi i këtyre ndarjeve formon sektorin e qeverisë Qëndrore. Sektori i Qeverisë Lokale gjithashtu është i ndarë në Njësitë Buxhetore dhe Njësitë Ekstra-buxhetore.

Përveç institucioneve buxhetore, sektori publik, përfshin edhe ndërmarrjet financiare, Bankën Qëndrore si dhe ndërmarrjet jo-financiare, të cilat janë në pronësi të qeverisjes së përgjithshme, duke ruajtur një nivel pavarësie në aktivitetin e tyre.

| Sektori Publik | | 2016 |
|--|-----------------|-------------|
| Nën sektor | | |
| Qeveria Qendrore | S.1311 | 898 |
| | Buxhetore | 835 |
| | Extra-Buxhetore | 63 |
| Qeveria Federale* | S.1312 | 0 |
| Qeveria Lokale | S.1313 | 282 |
| | Buxhetore | 192 |
| | Extra-Buxhetore | 90 |
| Fondet e Sigurimeve | S.1314 | 2 |
| Ndërmarrjet Publike Jo-financiare | S.11001 | 16 |
| Ndërmarrjet Publike Financiare | S.12201 | 3 |
| Banka Qendrore | S.121 | 1 |
| Total | | 1202 |

*S.1312 - Qeveria Federale, ky nën-sektor nuk aplikohet në Shqipëri